



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.11.2019, ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të shteteve anëtare të Konferencës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët, STCVW, 1978” ”. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Klajdi Qama, Edmond Leka, Ilir Pendavinji, Kujtim Gjuzi dhe Fadil Nasufi.

Mungojnë:

Gjetan Gjetani, Halit Valteri, Andrea Marto, Lefter Koka dhe Zef Shtjefni.

Të ftuar:

Hantin Bonati – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Thimjo Plaku – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Elson Thana – Specialist në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Niko Peleshi - Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit.

Kemi në shqyrtim projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të shteteve anëtare të Konferencës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët, STCVW, 1978”.

Kemi prezent përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, zotin Bonati, zëvendësministër, dhe përfaqësues të tjerë. Relator i marrëveshjes është zoti Leka.

Zoti Zëvendësministër, bëni një prezantim konciz, për efekt kohe, dhe më pas vazhdojmë me diskutimet dhe pyetjet.

Hantini Bonati – I nderuar kryetar,

Të nderuar anëtarë të komisionit parlamentar,

Jemi këtu për të bërë një prezantim shumë të shkurtër të projektligjit të propozuar nga ana jonë “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare për standardet e Kualifikimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët, STCVW, 1978” më 25 qershor 2010, ose siç quhet ndryshe, me ndryshimet e manilës 2010.

Në zbatim të detyrimeve që ka Shqipëria si shtet anëtar në Organizatën Ndërkombëtare Detare, me ligjin nr. 8569, datë 20 janar 2010, Republika e Shqipërisë aderoi në Konventën Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët për vitin 1978-1995. Qëllimi i kësaj konvente është forcimi i sigurisë lundrimore nëpërmjet zbatimit të standardeve më të larta të kompetencës dhe të profesionalizmit në detyrat që detarët kryejnë në bordin e anijes. Kjo konventë ka që në vitin 1978, ndryshimet e para janë bërë në vitin 1995 dhe ka pasur nevojë për ndryshime të mëtejshme, që janë bërë në vitin 2010, të cilat përditësojnë standardet e kërkuara të kompetencës, veçanërisht në dritën e ndryshimeve teknologjike; prezantojnë kritere dhe metodologji të reja kualifikimi dhe ritestimi për mekanizmat që do të zbatohen; përcaktohen kriteret për orët e punës dhe pushimit; parandalimit të abuzimit me drogën dhe alkoolin; standardet e gjendjes shëndetësore për punonjësit që do të jenë në pjesën detare.

Konkretisht, këto ndryshime konsistojnë në fushat e mëposhtme: rishikimin e orëve të punës dhe pushimit në bordin e anijes; kërkesa të reja për parandalimin e abuzimit me drogë dhe alkool; përmirësimin e standardeve për kontrollin mjekësor për detarët; parashikimin e kërkesave të reja për trajnimin dhe përdorimin e teknologjisë, telekomunikacionit, hartave elektronike dhe sistemeve të informacionit; parashikimin e kërkesave për trajnimin dhe

mbrojtjen e mjedisit detar; lidershipin dhe punën në grup; kërkesa të reja për trajtim dhe certifikim për oficerët elektronikë.

Ndryshimet e vitit 2010 vazhdojnë të theksojnë kompetencën e detarit në vendin e shërbimit ose gjatë periudhës së trajnimit. Standardi i përcaktuar nga konventa që po propozojmë zbatohet për të gjithë detarët, në të gjitha radhët që, kur shërbejnë anijet detare tregtare të regjistruara në flamurin e një shteti anëtar në konventë. Konventa me ndryshimet e manilës tashmë është pranuar nga të gjithë furnizuesit kryesor të punës dhe regjistrat e anijeve, duke përbërë 98% të flotës tregtare.

Për sa më sipër kërkoj mirëkuptimin tuaj, që ky projektligj të kalojë për miratim në parlament.

Niko Peleshi – Faleminderit për prezantimin!

Zoti Leka, urdhëroni!

Edmond Leka – Faleminderit, kryetar!

Projektligji vjen si nismë e Këshillit të Ministrave dhe ka për qëllim aderimin në aktin final të konferencës së shteteve anëtare të Konventës Ndërkombëtare të Standardizimit.

Miratimi i këtij akti do të ndikojë ndjeshëm në përmirësimin e standardeve kombëtare të nevojshme për trajnimin dhe kualifikimin e marinarëve të sotëm, duke u bazuar në standardet ndërkombëtare. Ndryshimet që përditësojnë standardet, veçanërisht në dritën e ndryshimeve teknologjike, prezantojnë kritere dhe metodologji të reja kualifikimi dhe testimi; detaje të orëve të pushimit për detarët; parandalimin e abuzimit me drogë dhe alkool; përcaktojnë standardet e gjendjes shëndetësore të detarëve; synojnë të përfshijnë metodologji të reja dhe kërkesa të reja në trajtimin dhe teknologjinë moderne.

Miratimi i projektligjit bëhet në zbatim të detyrimeve që kemi ndaj organizatës ndërkombëtare IMOS për aderimin në të gjitha konventat ndërkombëtare, ndaj ftoj të gjithë kolegët ta kalojmë në seancë plenare për miratim.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Ka pyetje apo diskutime? Nuk ka.

Votojmë në parim projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin final të shteteve anëtare të Konferencës Ndërkombëtare për Standardet e Kualifikimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët, STCVW, 1978”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? nuk ka.

Miratohet.

Votojmë nen për nen.

Neni 1.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA